

## ELBASAN- BANJË, LOTI 3

Punimet në lotin 3 të rrugës Elbasan - Banjë janë drejt përfundimit dhe shumë shpejt banorët e 7 fshatrave do të kenë një rrugë me standarde europiane. Aksi ka një gjatësi prej 8.5 km dhe përfshin fshatrat nga Gostima deri në Mollas. Deri tani kanë përfunduar 82% e punimeve, ndërsa financimi bëhet nga buxheti i shtetit në vlerën 1.3 miliardë lekë.

## OSHEE, INVESTIM 1 MILIARD LEKË NË TIRANË

Një investim në vlerën e 1 miliardë lekëve i OSHEE në Tiranë do të mundësojë rikonstruksionin e 408 kabinave elektrike si dhe shtrimin e 10 fiderave të rinj nga nënstacionet Selitë dhe Traktora. Investimi prek si tensionin e mesëm ashtu edhe atë të ulët ndërsa punimet pritet të përfundojnë para sezonit të dimrit të 2019-ës.

## TABELAT NË GJIROKASTËR- SARANDË

Autoriteti Rrugor Shqiptar vendosi tabelat emërtuese përgjatë aksit rrugor Gjirokastër-Sarandë. Tabelat e reja janë në përputhje të plotë me standardet e sigurisë të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe specifikimet teknike të përcaktuara posaçërisht në rrugë nacionale aty ku ka edhe zona të minoriteteve të ndryshme.

## NËNSTACION I RI ELEKTRIK NË FUSHË-KRUJË

Përmirësohet ndjeshëm cilësia e furnizimit me energji elektrike në Fushë-Krujë dhe fshatrat përreth. OSHEE ka investuar 1 miliardë lekë për ngritjen e nënstacionit mobile, ndërtimin e 5 fiderave 20 kv, ndërtimin e 120 kabinave, vendosjen e 2500 shtyllave si dhe shtrimin e 130 kilometra rrjet kabllor abc. Faza e dytë e punimeve përfshin ndërtimin e nënstacionit permanent që ju shërben afro 40 mijë banorëve.

## SHFRYTËZIMI I INDUSTRIË MINERARE

MIE organizoi në Tiranë konferencën e dytë ndërkombëtare "Zhvillimi integral i industrisë minerare me ndikim minimal në mjedis" me përfaqësues nga Shqipëria dhe Kosova. Në fokus ishte prezantimi i mundësive të shfrytëzimit dhe përpunimit të resurseve minerare të dy vendeve, si dhe zhvillimi i aktivitetit minerar me ndikim minimal në mjedis.

## PAKTI PËR UNIVERSITETIN

Në kuadër të Paktit për Universitetin dhe marrëveshjes së nënshkruar nga MIE me 3 Fakultete të Universitetit Politeknik, një grup studentësh të UPT nisën praktikën mësimore pranë OST, Njësia Operative Tiranë, ku janë njohur nga afër me ambientet dhe pjesët përbërëse të N/stacionit. Gjithashtu studentët kanë ndjekur remontin e planifikuar të zbarrave 110kV që u krye nga brigada e mirëmbajtjes të NjOT.